

DEKLARATË
E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
MBI REZOLUTËN E KONGRESIT AMERIKAN

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë përshëndet Rezolutën e Kongresit Amerikan në lidhje me anëtarësimin e tre vendeve të Kartës së Adriatikut, Shqipërisë, Maqedonisë dhe Kroacisë, në NATO para vitit 2007, si shprehje të vlerësimit më të lartë për kontributet dhe mbështetjen që këto vende kanë dhënë në forcimin e sigurisë rajonale dhe ndërkombëtare nëpërmjet një procesi të gjithanshëm reformues për ndërtimin e demokracive dhe shtetit të së drejtës në vendet e tyre.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë i shpreh falënderime Kongresit Amerikan për mbështetjen që i jep Shqipërisë në rrugën e saj për anëtarësim të plotë në NATO dhe e vlerëson atë mjaft inkurajuese në përpjekjet tona për thellimin e mëtejshëm të reformave dhe plotësimin e të gjitha standardeve të kërkuara, përfshirë edhe reformën në fushën e mbrojtjes.

Kjo Rezolutë është një mbështetje e fuqishme për politikën konstruktive dhe luajale të ndjekur nga Republika e Shqipërisë në ruajtjen, forcimin dhe konsolidimin e sigurisë rajonale, si dhe mbështetjen tonë për luftën kundër terrorizmit, nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në operacionet e rëndësishme, të tilla si "Liria e Irakut" dhe në Afganistan.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, duke vlerësuar mbështetjen e gjithanshme që SHBA i kanë dhënë dhe i japin Shqipërisë në rrugën dhe përpjekjet e saj për integrimin dhe përfshirjen në botën e vlerave të lirisë dhe demokracisë, të mishëruara në strukturat euroatlantike, të riafirmuar me miratimin e kësaj Rezolute, shpreh bindjen se kjo mbështetje edhe në të ardhmen nuk do të na mungojë për të bërë realitet aspiratat e qytetarëve të këtij vendi.

Kjo Rezolutë duhet të na shërbejë që të gjithë së bashku të punojmë pa u lodhur për të thelluar reformat dhe përmushur detyrimet tona, për të kontribuar të gjithë realisht në realizimin e objektivave madhorë të politikës sonë të jashtme nëpërmjet një procesi gjithëpërfshirës, Kuvend, Qeveri, pozitë dhe opozitë, aktorë të rëndësishëm të shoqërisë civile dhe sipërmarrjes private.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë shpreh bindjen dhe angazhimin e tij maksimal për të garantuar përmbushjen në kohë të të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga plani i veprimeve për anëtarësim në NATO dhe ato në kuadër të Kartës së Adriatikut, me qëllim që Samiti i ardhshëm t'i hapë rrugën integritetit të plotë në NATO.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë përshëndet anëtarësimin në Aleancën më të fuqishme ushtarake të historisë së njerëzimit, NATO, të Bullgarisë, Estonisë, Letonisë, Lituanisë, Rumanisë, Sllovakisë dhe Sllovenisë dhe vlerëson mirëseardhjen e ngrohtë që Kongresi Amerikan rezervoi për ta, duke shpresuar që në një të ardhme shumë të shpejtë ky vlerësim i merituar do t'i rezervohet edhe Shqipërisë.